

Është hapur thirrja për projekte për bashkëpunim evropian në kuadër të programit Evropa Kreative - nënprogrami Kultura për vitin 2025 me afatin e fundit për dorëzimin e propozime-projekteve, 13 maj 2025 deri në orën 17:00 (sipas kohës së Evropës Qendrore).

Mbështetja e Bashkimit Evropian në kuadër të thirrjes për Projekte për bashkëpunim evropian dedikohet për projekte me spektër të gjerë të aktiviteteve dhe nismave që përfshijnë organizata nga sektori kulturor dhe kreativ në 40 vendet pjesëmarrëse në programin Evropa Kreative - nënprogrami Kultura.

Me buxhet prej 59. 979. 335 milionë euro për vitin 2025, pritet të mbështeten rreth 130 projekte, të cilat do të mundësojnë bashkëpunim ndërmjet organizatave aktive në fushën e kulturës në vendet pjesëmarrëse në Programin e Evropës Kreative - Nënprogrami Kultura me qëllim që të forcojë dimensionin transnacional të krijimit dhe qarkullimit të përmbajtjes artistike evropiane, lëvizshmërinë e artistëve dhe profesionistëve nga sektorët përkatës, shkëmbimin e njohurive dhe përvojave ndërmjet organizata kulturore, etj. Gjithashtu pritet që përmes projekteve të inkurajohet zhvillimi, eksperimentimi, shpërndarja e informacioneve dhe aplikimi i praktikave të reja dhe inovative.

QËLLIMET E THIRRJES

Qëllimi 1– Krijimi transnacional dhe qarkullimi:

Forcimi i krijimit dhe qarkullimit transnacional të veprave dhe artistëve evropianë

Krijimi dhe qarkullimi transnacional janë thelbësore për avancimin e bashkëpunimit, zgjerimin e shtrirjes dhe, në shumë raste, qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e organizatave, institucioneve dhe individëve kulturore. Bashkëproduksioni është mjet për nxitjen e krijimtarisë, ndarjen e burimeve dhe lehtësimin e shpërndarjes transnacionale të përmbajtjes dhe lëvizshmërisë së artistëve. Projektet duhet të marrin parasysh kontekstin e ri, si sfidat shëndetësore ose mjedisore, dhe të integrojnë mënyra inovative (digjitale) të krijimit dhe shpërndarjes së përmbajtjeve.

Qëllimi 2 – Inovacioni:

Rritja e kapaciteteve të sektorëve kulturorë dhe kreativ evropianë për të mbështetur talentet, zhvillimin e inovacioneve, prosperitetin gjegjësisht krijimin e vendeve të punës dhe rritjen ekonomike.

Projektet që përmbushin këtë qëllim duhet të synojnë forcimin e kapaciteteve, të cilat mund të jenë të natyrës teknologjike dhe/ose artistike. Kjo mund të përfshijë zhvillimin dhe testimin e praktikave ose modeleve të reja si dhe përhapjen e praktikave inovative.

Inovacioni mund t'i referohet edhe një dimensioni social, përkatësisht përfshirja dhe zhvillimi i audiencës, barazia gjinore, përfshirja e personave me aftësi të kufizuara, anëtarëve të pakicave dhe grupeve të marginalizuara shoqërore, lufta kundër ndryshimeve klimatike, digjitalizimi, etj. Gjithashtu, kultura mund të kontribuojë në shëndetin dhe mirëqenien, veçanërisht shëndetin mendor, duke marrë parasysh të dhënat ekzistuese dhe krizën e vazhdueshme të shëndetit mendor që prek veçanërisht të rinjtë.

Pjesë përbërëse e synimeve dhe prioriteteve të projekteve të propozuara janë çështjet ndërsektoriale (Cross Cutting Issues), përkatësisht: përfshirja, diversiteti, barazia gjinore dhe çështjet ekologjike që kontribuojnë në luftën kundër ndryshimeve klimatike.

Projektet e bashkëpunimit evropian janë të hapura për të gjithë sektorët kulturorë dhe kreativ. Duke pasur parasysh se kjo thirrje është pjesë e nënprogramit- Kultura, projektet me përmbajtje ekskluzive audio-

vizuale dhe/ose të përbëra ekskluzivisht nga organizata të sektorit audio-vizual nuk kanë të drejtë të aplikojnë..

Kategoritë e thirrjes

Risi: Thirrja për bashkëpunim evropian për vitin 2025 ka të bëjë me tre kategori:

- CREA-CULT-2025-COOP-1 projekte bashkëpunimi (në vëllim të vogël): minimalisht 3 partnerë nga 3 vende të kualifikuara/Grant i BE-së deri në 200,000 euro (deri në 80% të buxhetit të projektit)
- CREA-CULT-2025-COOP-2 projekte bashkëpunimi të (në vëllim të mesëm): minimum 5 partnerë nga 5 vende të kualifikuara/ grant i BE-së deri në 1000,000 euro (deri në 70% të buxhetit të projektit)
- CREA-CULT-2025-COOP-3 projekte bashkëpunimi (në vëllim të gjerë): minimalisht 10 partnerë nga 10 vende të kualifikuara/Grant i BE-së deri në 2000,000 euro (deri në 60% të buxhetit të projektit)

Kohëzgjatja e projekteve nga tre kategoritë është maksimumi 48 muaj.

Aplikues të kualifikuar

Persona juridikë (private dhe publike) me seli (të regjistruara) në një nga 40 vendet pjesëmarrëse në programin Evropa Kreative- nënprogrami Kultura. Personat fizikë nuk kanë të drejtë të aplikojnë në program.

Afati i aplikimit

Afati i fundit për dorëzimin e propozim-projekteve është 13 maj 2025, deri në orën 17:00 sipas kohës së Evropës Qendrore.

Aplikacionet dorëzohen në mënyrë elektronike nëpërmjet „Funding & Tenders Opportunity Portal“:

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/calls-for-proposals?order=DESC&pageNumber=1&pageSize=50&sortBy=startDate&isExactMatch=true&status=31094502&frameworkProgramme=43251814&callIdentifier=CREA-CULT-2025-COOP>

Më shumë informacione rreth kritereve dhe mënyrës së dorëzimit të propozim-aplikimit mund të gjeni në dokumentin për thirrjen (COOP Call Document 2025. Version 1.0 i datës 10 dhjetor 2024):

https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/docs/2021-2027/crea/wp-call/2025/call-fiche_crea-cult-2025-coop_en.pdf